



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 211/2013**

**17 janar 2014**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 69/2013, datë 28.12.2013	Për përcaktimin e masës së përfitimit financiar mujor për shërbimin e transportit të deputetëve .....	9251
Vendim i Kuvendit nr. 70/2013, datë 28.12.2013	Për disa shtesa në vendimin e kuvendit nr. 48/2013, “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar .....	9252
	Ndreqje gabimi .....	9253

**VENDIM**  
**Nr. 69/2013**

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË PËRFITIMIT FINANCIAR MUJOR PËR SHËRBIMIN  
E TRANSPORTIT TË DEPUTETËVE**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, të nenit 1, pika 2, të ligjit nr. 169/2013, datë 7.11.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 160, datë 15.10.2009, “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”, si dhe të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e deputetit Taulant Balla,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Masa e përfitimit financiar mujor për çdo deputet për shërbimin e transportit përcaktohet sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Përfitimi financiar mujor për shërbimin e transportit të mos i nënshtrohet tatimit.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare prej datës 18.12.2013.

**KRYETARI**  
**Ilir Meta**

Miraturar në datën 28.12.2013

Lidhja nr. 1

**MASA E PËRFITIMIT FINANCIAR MUJOR PËR SHËRBIMIN  
E TRANSPORTIT TË DEPUTETËVE**

<b>Nr.</b>	<b>Qarku</b>	<b>Vlera mujore (në lekë)</b>
<b>1</b>	<b>Tiranë</b>	<b>30 016</b>
<b>2</b>	<b>Durrës</b>	<b>31 214</b>
<b>3</b>	<b>Lezhë</b>	<b>34 035</b>
<b>4</b>	<b>Elbasan</b>	<b>33 702</b>
<b>5</b>	<b>Dibër</b>	<b>40 000</b>
<b>6</b>	<b>Vlorë</b>	<b>40 000</b>
<b>7</b>	<b>Shkodër</b>	<b>40 000</b>
<b>8</b>	<b>Fier</b>	<b>40 000</b>
<b>9</b>	<b>Berat</b>	<b>40 000</b>
<b>10</b>	<b>Kukës</b>	<b>40 000</b>
<b>11</b>	<b>Korçë</b>	<b>40 000</b>
<b>12</b>	<b>Gjirokastrë</b>	<b>40 000</b>



**VENDIM**  
**Nr. 70/2013**

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 48/2013, “PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, të neneve 55, pika 1, dhe 21, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në vendimin e Kuvendit nr. 48/2013, “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

- I. Deputeti Luan Duzha caktohet anëtar në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.
- II. Deputetja Kejdi Mehmetaj caktohet anëtare në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.
- III. Deputetja Silva Caka caktohet anëtare në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.
- IV. Deputetja Miranda Rira caktohet anëtare në Komisionin për Çështjet Sociale, Punën dhe Shëndetësinë.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Ilir Meta**

Miratuar në datën 28.12.2013

### Ndreqje gabimi

1. Në ligjin nr. 163/2013, datë 24.10.2013, botuar në Fletoren Zyrtare nr.183, datë 19 nëntor 2013, në faqen 7737, në paragrafin e fundit të aneksit E,

**Ishte:**

...prej 35 (tridhjetë ditësh)...

**Bëhet:**

...prej 35 (tridhjetë e pesë ditësh)...

2. Në ligjin nr. 164/2013, datë 24.10.2013, botuar në Fletoren Zyrtare nr.183, datë 19 nëntor 2013, në faqen 7741, në nenin 3 “Huaja e butë”, pika 3.2,

**Ishte:**

...35 % (gjashtëdhjetë për qind)...

**Bëhet:**

...35 % (tridhjetë e pesë) për qind....

3. Në shtojcën E në paragrafin e fundit, në faqen 7751 në rreshtin e fundit,

**Ishte:**

...prej 35 (tridhjetë ditësh)...

**Bëhet:**

...prej 35 (tridhjetë e pesë ditësh)...

4. Në ligjin nr. 165/2013, datë 24.10.2013, botuar në Fletoren Zyrtare nr.183, datë 19 nëntor 2013, në faqen 7755, në nenin 3 “Huaja e butë”, pika 3.2,

**Ishte:**

...prej 75% (gjashtëdhjetë për qind)...

**Bëhet:**

... prej 75% (shtatëdhjetë e pesë) për qind...

5. Në ligjin nr. 165/2013, datë 24.10.2013, botuar në Fletoren Zyrtare nr.183, datë 19 nëntor 2013, në faqen 7766, në aneksin E, paragrafi i fundit,

**Ishte:**

...prej 35 (tridhjetë ditësh)..

**Bëhet:**

...prej 35 (tridhjetë e pesë ditësh)

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2014, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2014

Çmimi 8 lekë